# Udhëzues për aplikimin në Maturë Shtetërore nga portali qeveritar

## 1. Krijimi i profilit në portalin qeveritar

– Nëse ju nuk keni një profil në portalin qeveritar veproni si më poshtë:

Hapni browser-in (Mozilla Firefox,Google Chrome, Internet Explorer) dhe klikoni www.e-albania.al




Fillimisht bëjmë regjistrimin në portal. Për këtë ju duhet të klikoni te shenja .

Më pas do plotësoni të dhënat siç kërkohen më poshtë:







Mos harroni të plotësoni pyetjen e sigurisë dhe përgjigjen tuaj, në rast harrimi të fjalëkalimit

← Klikoni Pranoj kushtet

← Klikoni Regjistrohu

Fushat që do të plotësoni janë:

- Kodi i përdoruesit (është numri personal që gjendet në kartën tuaj të identitetit, pasaportë apo çertifikatë, siç tregohet në figurën më sipër).
- Fjalëkalimi: (vendosni një fjalëkalim tuajin).
- Fjalëkalimi përsëri: (ripërsëritni fjalëkalimin e vendosur më sipër).
- E-mail (**KUJDES!!** Vendosni një e-mail të vlefshëm dhe të saktë pasi do ju duhet në proçedurat e mëvonshme).
- Nr. Celular (vendosni një numër të saktë pasi për tu bërë i vlefshëm regjistrimi do merrni një kod që duhet ta përdorni brenda 120 sekondave).
- Pyetja e sigurise dhe Pergjigja (Plotësojini këto dy fusha në rast se harroni fjalëkalimin tuaj).

Më pas vazhdoni me plotësimin e pjesës së dytë:

**KUJDES!!** Të dhënat duhet të jenë të sakta siç janë në dokumentat tuaj të identitetit. Këto të dhëna janë:

- Emri
- Atësia
- Mbiemri
- Datëlindja
- Nr. i letërnjoftimit (është numri që ka dokumenti juaj i identitetit – është i ndryshëm nga numri personal).

Klikoni mbi katror si në figurë 

dhe më pas shtypni butonin **Regjistrohu.**

Një kod do t'iu vijë në numrin tuaj të celularit që duhet ta përdorni brenda 120 sekondave.







Klikoni **Vazhdo**. Në këtë moment profili juaj është krijuar.

Në adresën tuaj të email-it do t'ju vijë konfirmimi.

## 2. Logimi në portalin qeveritar (Kjo vlen për përdoruesit e rinj që sapo krijuan profilin dhe ata ekzistues që e kanë tashmë një profil).

Më pas klikoni te butoni **Hyr**  tek 

Klikoni te **Indentifikimi i qytetarëve/bizneseve me fjalëkalim**.




Vendosni kredencialet tuaja (numrin personal dhe fjalëkalimin tuaj) dhe më pas **IDENTIFIKOHU**.




Do t'ju shfaqet pamje si në figurën më poshtë. Te fusha e kërkimit kërkoni me **Matura Shtetërore.**



Pasi të jeni futur te Matura Shtetërore kliko **përdor**.




Tashmë e keni mundësinë që të nisni aplikimin me formularët A1 apo A1Z duke klikuar **Apliko** figura më poshtë:



## 3. Formularët A1 / A1Z

Klikojmë tek **Apliko** duke zgjedhur formularin **A1** ose **A1Z** (përzgjedhja në përputhje me udhëzimet e MAS).

### 3.1 Formulari A1

Do ngarkohen automatikisht të dhënat tuaja personale (Pikat nga 1-6)


FORMULARI A1

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE
Plotësohet vetëm nga maturantët që përfundojnë shkollën e mesme

*I. Të dhëna personale.*
*1. Nr Personal në letërnjoftimin ID*
*2. Emri:* *Atësia:* *Mbiemri:*
*3. Datëlindja (dd/mm/vv):*
*4. Vendlindja e maturantit:*
*5. Gjinia:* Mashkull Femer
*6. Adresa email:* *Celulari i kontaktit (*):*
*I. Të dhëna shkollore.*
*7. Prefektura (*):* Zgjidh
*8. Qyteti / Fshati:*
*9. Emri i shkollës ku studion (*):*
*10. Indeksi i profilit:*
*11. Emërtimi i profilit:*
*12. Klasa III / IV:*
*(A, B, C, D, E, F, G, H, I, J, K, L, M, N, O, P, Q, R, S, T):* Viti: III IV V A
*13. Do të aplikoni për studime jashtë vendit:* Po Jo
*14. Gjuha e huaj e detyruar qe do te jape provim:D3 (*):*
*I. Të dhëna lëndore.*
*15. Lëndët me zgjedhje:*
Zgjidh
Zgjidh
*Shuma e krediteve:*

Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë.
Përjashtim bëjnë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

Mbyll formën Dergo

Do filloni me plotësimin e të dhënave shkollore.
Në figurën e mëposhtme është treguar një shembull:

- Te pika 7 Plotësoni Prefekturën tuaj (Zgjidhni nga Lista, figura më poshtë)

*Në shembullin e marrë, Tiranë* (figura më poshtë)

- Zgjidhni shkollën tuaj në Pikën 9, Automatikisht do të plotësohet Pika 8 (Qyteti/Fshati)
- Pika 10 dhe 11 do plotësohet në shkollë (nuk keni të drejta ti plotësoni)
- Zgjidhni Vitin (III,IV,V) dhe Klasën (A,B,C,… ) te Pika 12
- Te Pika 13 shtypni te Po ose Jo në varësi të faktit nëse do të aplikoni ose jo për studime jashtë vendit
- Te Pika 14 zgjidhni nga lista gjuhën e detyruar që do të jepni

Në shembullin e marrë, Anglisht D3,

Më pas zgjidhni dy lëndët me zgjedhje nga lista. Përbri gjeni dhe shumën e krediteve përkatëse.




**KUJDES!!** Plotësimi të bëhet në përputhje me udhëzimet e MAS.
Pasi të jeni siguruar klikoni butonin **Dërgo**.

Do merrni njoftimin: Paraqituni në shkollë të përfundoni aplikimin!




I njëjti mesazh do t'iu vijë dhe në celularin dhe adresën tuaj të e-mail.

Klikoni **Dil** për të dalë nga portali qeveritar.

## 3.2 Formulari A1Z

Do të ngarkohen automatikisht të dhënat tuaja personale (Pika 1-6)



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

# FORMULARI A1Z

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE**
**Plotësohet vetëm nga ata që kanw kryer shkollwn e mesme para vitit korrent.**

*I. Të dhëna personale.*

*1. Nr Personal në letëmjoftimin ID*

*2. Emri:* — *Atësia:* — *Mbiemri:*

*3. Datëlindja (dd/mm/vv):*

*4. Vendlindja e maturantit:*

*5. Gjinia:* ( ) Mashkull (•) Femer

*6. Adresa email:* — *Celulari i kontaktit (*):*

*II. Të dhëna shkollore.*

*7. Prefektura (*):* TIRANE

*8. Qyteti / Fshati:* TIRANE

*9. Emri i shkollës ku studion (*):* TIRANE - 399 - SINAN TAFAJ

*9.1 Shkolla që keni përfunduar:* ( ) E njëjtë (•) Tjetër — Eqrem Cabej

*10. Indeksi i profilit:*

*11. Emërtimi i profilit:*

*12. Do të aplikoni për studime jashtë vendit:* (•) Po ( ) Jo

*III. Të dhëna lëndore.*

*13. ID e kandidatit:*

*14. Viti i përfundimit të shkollës së mesme:* 2014

*15. Lëndët e detyruara:*

*15.1 Lëndët e detyruara që do të mbarten:*

*Lënda D1:* — *Nota e shkallëzuar:*

*Lënda D2:* — *Nota e shkallëzuar:*

*15.2 Lëndët e detyruara që do të japësh provim:*

*Lënda D1* — *Lënda D2*

*16. Lëndët me zgjedhje:*

*16.1 Lëndët me zgjedhje që do të mbarten:* (•) Jo ( ) 1 ( ) 2

*Viti* 2014 *Lënda Z1* — *Nota e shkallëzuar:*

*Viti* 2014 *Lënda Z2*

*Nota e shkallëzuar:*

*16.2 Zgjidh lëndët me zgjedhje që do të japësh provim:*

*Shuma e krediteve:*

Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë.
Përjashtim bëjnë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

[Mbyll formën] [Dergo]

Do të filloni me plotësimin e pjesës së dytë : **Të dhëna shkollore**.

- Te pika 7 Plotësoni Prefekturën tuaj (Zgjidhni nga Lista më sipër)

  *Në shembullin e marrë më sipër Tiranë*

- Zgjidhni shkollën ku po bëni aplikimin në Pikën 9 (shkolla që ju është caktuar), Automatikisht do të plotësohet Pika 8 (Qyteti/Fshati)
  *Në shembullin e marrë më sipër Sinan Tafaj*

  Në pikën 9.1 do klikoni ◉ E njëjtë nëse shkolla ku po bëni aplikimin është e njëjtë me shkollën ku keni ndjekur studimet / përfunduar studimet.

  Në pikën 9.1 do klikoni ◉ Tjetër dhe do të vendosni emrin e shkollës nëse shkolla ku po bëni aplikimin nuk është e njëjtë me shkollën ku keni ndjekur studimet / përfunduar studimet.
  *Në shembullin e marrë më sipër Eqrem Çabej*

- Pika 10 dhe 11 do plotësohet në shkollë (nuk keni të drejta ti plotësoni)
- Te Pika 12 shtypni te Po ose Jo në varësi të faktit nëse do të aplikoni ose jo për studime jashtë vendit

Pjesa e tretë **Të dhëna lëndore** do të plotësohen në shkollë në prani të mbikqyrësit në shkollën ku ju jeni përcaktuar për të aplikuar në përputhje me udhëzimet e miratuara nga MAS

**KUJDES!!** Plotësimi të bëhet në përputhje me udhëzimet e MAS.
Pasi të jeni siguruar klikoni butonin **Dërgo**.

Do merrni njoftimin : Paraqituni në shkollë të përfundoni aplikimin!




I njëjti mesazh do t'iu vijë dhe në celularin dhe adresën tuaj të e-mail.

Klikoni **Dil** për të dalë nga portali qeveritar.



**4. Harruat fjalëkalimin tuaj?**

Në qoftë se maturanti e ka krijuar më herët profilin, por nuk mban mend fjalëkalimin mund të veprojë si më poshtë:
Vendos kredencialet e veta

- Numër Personal
- Një fjalëkalim çfarëdo

Kliko **IDENTIFIKOHU**




- Do të shfaqen mesazhet:
  - Identifikimi dështoi
  - Harruat fjalëkalimin tuaj? (sipër butonit **IDENTIFIKOHU**)




- Klikoni mbi mesazhin Harruat fjalëkalimin tuaj?
- Në dritaren që do të shfaqet plotësoni dhe një herë Kodin e përdoruesit (Numrin tuaj Personal)
- Klikoni butonin **Vazhdoni**




Përgjigjuni pyetjes së sigurisë që keni plotësuar kur keni bërë regjistrimin tuaj:



Përgjigjuni pyetjes së sigurisë që keni plotësuar në regjistrimin tuaj:

- Vendlindja e nënës
- Mësuesja e preferuar




- Në këtë moment do të njoftoheni me anë të një mesazhi:

**Gjenerimi i fjalëkalimit të ri u krye me sukses. Fjalëkalimi i ri u dërgua në email-in tuaj.**




- Pasi të hapni email-in tuaj merrni fjalëkalimin
  - ***Kujdes!! Email mund të vijë dhe si Spam***



I dashur Qytetar,

Ju falenderojmë për përdorimin e Portalit Qeveritar.

**Fjalekalimi juaj ndryshoi ne:**

| Po ju dërgojmë detajet e mëposhtme per t'Ju informuar: | |
|---|---|
| Emri i shërbimit për këtë transaksion është: | |
| Emri i llogarisë kryesore (Përdoruesi): | |
| Subordinate account name (i.e. Assistant): | |

Ky është mesazh informues. Adresa dërguese nuk monitorohet. Ju lutemi, mos u përgjigjni.

Faleminderit

Portali Qeveritar

- Logohuni me kredencialet e reja.

Faleminderit.

Suksese.